



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.12, datë 20.06.2018

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT
“PISHA”, NË PËRROIN E HOLTËS, BASHKIA GRAMSH, QARKU ELBASAN”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Pisha”, në përroin e Holtës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, me subjekt zhvillues shoqërinë “Greentech Energy Systems” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Gramsh.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
E DI RAMA**



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

